



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 300

Datë: 15.06.2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 24 paragrafi 1, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008", nenit 2, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008", nenit 19 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008", bazuar në nenin 10, nenin 19 paragrafi 7 shkronja (b), nenin 38 dhe 40, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës:12.11.2008, kërkesën Nr.04/462 datë: 01.06.2022 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur, me datë: 13.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KORNIZES AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË
MALISHEVËS 2023-2025

1. Miratohet Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Malishevës (KAB) për vitet 2023-2025, me theks të veçantë, për vitin 2023 të përcaktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

2.Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2023 përmban këta kufij buxhetorë:

Paga dhe medijtje	9,305,272.00
Mallra dhe shërbime	2,035,160.00
Komunali	655,000.00
Subvencione dhe transfere	700,000.00
Investime kapitale	5,429,406.00
Tatali:	18,124,838.00€

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Malishevës (KAB) për vitet 2023-2025.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet

Arkivit të Komunës

MAPL-së

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Malisheve
Drejtoria per Buxhet dhe Financa

01/06/2022
04/462

DATË/A:	01.06.2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z.Argjend Thaçi-Kryesues i K.K.Malishevë
ACC:	
NGA/OD/FROM:	Ekrem Kastrati-Kryetar i K.K.Malishevë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Blerim Thaçi-Drejtor përkonomi buxhet dhe financa
KOPJE:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për miratimin e KAB-it Komunal 2023-2025

Të nderuar!

Bazuar në qarkoren buxhetore 2023/1 të datës 13.05.2022 të nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku ofrohen udhëzimet fillestare për hartimin e buxhetit për vitin fiskal 2023 dhe vlersimet për vitet 2024-2025, Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) komunale të cilën ja paraqesim Komitetit për Politikë dhe Financa që të njejtin ta shqyrtoj dhe ta dërgoj në Kuvend për miratim.

Kufijt bu dhe projeksionet buxhetore për vitin 2023 dhe projeksionet buxhetore 2024-2025 i janë bashkangjitur kësaj shkrese.

Respekt!